



UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНІВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

FAKULTETI
JURIDIK

PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE

(Master of Arts)

TITULLI I PROGRAMIT:

STUDIME PËR TË DREJTËN PENALE

HYRJE

FAKULTETI JURIDIK

1. Institucioni/organi për dhënien titullit Universiteti i EJL-së

<p>2. Institucioni arsimor</p> <p>3. Vendi i mbajtjes së mësimit</p> <p>4. Program i akredituar nga:</p> <p>5. Grada finale shkencore</p> <p>6. Programi</p> <p>7. Data e përpunimit/revizionit</p> <p>8. Grupi i studentëve</p> <p>9. Qëllimet mësimore të programit</p> <p>10. Deri në mbarimin e programit, studentët do të pajisen me njohuri dhe do t'i kuptojnë të gjitha sferat e së drejtës penale, siç janë: e drejta penale materiale, e drejta penale ndërkombëtare, procedura penale, mjekësia ligjore, kriminologjia, tregtia me njerëz, penologjia, delikuenca e të miturve dhe të ngjashme, si dhe për rregulla qenësore, relevante për fushat kyçe të së drejtës penale, perspektivat teorike dhe debatet akademike, të cilat në mënyrë qenësore i vënë në dukje fushat juridike, aspektet kyçe, problemet politike dhe parimet e ndërlidhura me ratifikimin e konventave të caktuara ndërkombëtare për luftën kriminale të organizuar në shtet;</p> <p>11. Studentë me sukses do të mund t'i zbatojnë njohuritë e fituara nga e drejta penale në shumë situata ku shqyrtohen problemet relevante praktike ose teorike;</p> <p>12. T'i vlerësojë problemet në bazë të kontekstit, relevancës dhe rëndësisë të tyre dhe t'i ndërlidh informacionet relevante dhe burimet kyçe nëpërmjet mjeteve elektronike ose mjeteve tjera;</p> <p>13. T'i vlerësojë problemet dhe të gjejë zgjidhje për lidhur me zbatimin e të drejtës penale në shtet, t'i formulojë argumentet për problemet kryesore dhe sferat kontraverze dhe të prezantojë mendim racional të bazuar në materiale relevante;</p> <p>14. T'i njohë argumentet potenciale alternative dhe dëshmitë kundërthënëse sipas mendimit të vetë dhe t'i prezantojë;</p> <p>15. Të demonstrojë mendimin e lirë dhe aftësi për të ofruar nxitje kritike për njohuritë e fituara për probleme individuale dhe të jetë konstruktiv në progresin shkencor.</p>	<p>Universiteti i EJL-së</p> <p>Kampusi i UEJL-së (Tetovë)</p> <p>Këshilli i akreditimit</p> <p>M.A.</p> <p>Studime për të drejtën penale</p> <p>Shtator 2007</p> <p>Gjenerata e vitit akademik 2008/2009</p>
<p>16. Rezultati i mësimit</p> <p>Cikli i dytë i programit për të drejtën penale do të ofrojë njohuri solide dhe kuptim sistematik për strukturat institucionale, parimet kyçe juridike dhe kontekstet e caktuara të së drejtës penale.</p> <p>Njohuritë e fituara</p> <p>Ligjëratat/mësimi, metodat dhe strategjitë e vlerësimit të cilat përdoren për arritjen dhe prezentimin e rezultateve</p> <p>A. Njohuritë e fituara dhe shqyrtimet</p> <p>Ligjëratat/mësimi</p>	

1. Ky program do t'ju mundësojë studentëve kualifikime të vlefshme pasuniversitare, sidomos atyre që kanë për qëllim të marrin rolin udhëheqës në procesin e luftës kundër kriminalitetit dhe posaçërisht kundër formave moderne të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

2. Të fitojnë shkathtësi të vlefshme komunikuese ata të cilët janë të interesuar për punësim, pas mbarimit të studime pasuniversitare në sektorët e punëve të brendshme dhe në politik, gjykatat dhe në prokurori.

3. Programi do t'ju mundësojë studentëve fitimin e shkathtësive për t'u ballafaquar me problemet juridike lidhur me kriminalitetin, krimin e organizuar, korrupsionin dhe të ngjashme, dhe do t'i nxis studentët në zhvillimin e vetëdijes kritike për funksionimin e organeve të shtetit, të involvuara në luftën kundër kriminalitetit.

4. Ky program do t'ju vijë në ndihmë atyre kandidatëve të cilët e vazhdojnë karrierën e tyre në fushën e të drejtës penale.

Ligjëratat do të ndiqen nëpërmjet tri orëve të seminare, të cilat do të mbahen çdo të ditën javë. Në fillim të ligjëratave, ligjëruesi do ta paraqes kontekstin e përgjithshëm të lëndës dhe ekspozenë e problemeve kyçe dhe do t'i vë në dukje sferat për të cilat do të diskutohet në të ardhmen. Këtë hyrje që do ta gjejnë studentët në literaturën e rekomanduar, ka për qëllim t'i fokusojë seminarët në diskutime të hollësishme për tema të caktuara, thjeshtë të bazuara në prezantime dhe ese nga ana e studentëve dhe aplikimi i diskutimeve për probleme kritike. Prezantimet kërkojnë nga studentët të formojnë pikëpamjet e tyre për fushën përkatëse dhe të zhvillojnë diskutime me ligjëruesin dhe me studentët.

Vlerësimi

Vlerësimi i njohurive të fituara nga lëndët dhe kombinimi provimeve me shkrim (kolokuiume dhe provimi final) esetë e përbërë prej 4000 deri më 5000 fjalë, të cilat patjetër duhet të dorëzohen për çdo lëndë të ndjekur, kolokuiumi dhe provimi final. Pjesa tjetër e programit kërkon nga studentët të hulumtojnë, të shkruajnë dhe ta dorëzojnë disertacionin e bërë prej 15.000 deri më 20.000 fjalë, pas caktimit paraprak të temës nga fusha e së drejtës penale., dhe nën mbikëqyrjen e një anëtari të kuadrit akademik me përvojë nga fusha përkatëse.

B. Shkathtësitë dhe karakteristikat tjera

Aftësitë për bartjen e shkathtësive intelektuale. Ligjëratat/mësimi

Pas kryerjes me sukses të programit studentët mund:

1. Të japin komente origjinale dhe të avancuara, të cilat do t'i plotësojnë standardet e larta shkencore dhe të zhvillojnë shkathësi kritike, analitike dhe hulumtuese, të cilat mund të zbatohen në shumë fusha;

2. T'i zhvillojnë shkathësitë nga sfera e hulumtimeve juridike akademike, posaçërisht nëpërmjet prezantimit me shkrim të argumenteve në frymën në të cilën i integron rregullat relevante akademike dhe të krijojnë një bazë të mirë lidhur me teknikat e domosdoshme dhe metodat hulumtuese, të cilat janë pjesë e lëndëve të specializuara;

3. Ta vazhdojnë karrierën e tyre në të drejtën penale në nivel akademik dhe në nivel praktik.

Shkathësitë e numëruara intelektuale zhvillohen para së gjithash nëpërmjet përgatitjes dhe pjesëmarrjes në seminare, dhe shumë pak përmes leksioneve formale. Kjo mundëson që politikat dhe interpretimet e ndryshme të së drejtës të studiohen në mënyrë kritike, kurse pozicionet alternative të vlerësohen në mënyrë krahasimtare.

Prezantimi i seminareve mund në mënyrë të plotë të orientohet në ato sfera, të cilat lejojnë hapësirë për diskutim dhe debate dhe për të cilat ekziston interes përkatës. Në vazhdim, vlerësimi i lëndës i lejon dhe i nxit diskutimet dhe prezantimet e avancuara të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat e shprehjes akademike.

Aplikimi dhe zgjidhja e rasteve juridike

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:

1. Me hulumtimin dhe përgatitjen e disertacionit t'i zhvillojnë shkathtësitë hulumtuese. Mbikëqyrja gjatë përgatitjes së disertacionit ju mundëson studentëve të mendojnë në mënyrë individuale dhe progresive;

2. Të zhvillojnë një nivel të lartë përmes disertacioneve të tyre dhe, njëkohësisht ju mundëson që shkathtësitë e ndryshme të studentëve të vinë në shprehje bashkë me punimin e shkruar të magjistraturës;

3. T'i identifikojnë rastet në bazë të përvojave të mëhershme juridike;

4. Të mendojnë për shkakun dhe të jenë të informuar mirë për veprimet e mundshme ligjore, të cilat rrjedhin nga ky mendim, si dhe nga mundësitë e suksesit.

Vlerësimi

Aftësia për zgjidhjen e problemeve juridike kryesisht zhvillohet përmes përgatitjes dhe pjesëmarrjes në orët e këtij programi.

Pas seminareve të mbajtura në gjuhën angleze nga ana e kuadrit ndërkombëtar për së afërmi njihen me metodat mësimore juridike të lejuara në vendet e Europës Perëndimore dhe universitetet amerikane.

Vlerësimi

Vlerësimi bëhet në pyetjet e shtruara rreth lëndës konkrete në provimin me shkrim dhe në vlerësimin e lëndës, duke i përfshirë edhe testet në orë.

Burimet, hulumtimet, dhe vlerësimi	Ligjëratat/mësimi
<p data-bbox="131 262 682 336">Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:</p> <p data-bbox="131 367 682 483">a) Ta vazhdojnë karrierën e tyre në sferën e së drejtës penale në nivelin akademik dhe në nivelin praktik;</p> <p data-bbox="131 514 682 588">b) T'i identifikojnë çështjet juridike dhe çështjet tjera që duhet të hulumtohen;</p> <p data-bbox="131 598 682 672">c) T'i shfrytëzojnë në mënyrë efikase burimet sekondare dhe primare;</p> <p data-bbox="131 703 682 808">ç) Të bëjnë hulumtime të pavarura juridike, duke shfrytëzuar një varg burimesh;</p> <p data-bbox="131 840 682 997">d) T'i vlerësojnë në mënyrë kritike sferat e së drejtës penale, si nga aspekti i doktrinës, po ashtu edhe nga aspekti shoqëror;</p> <p data-bbox="131 1029 682 1249">dh) Të zhvillojnë nivel të lartë, të sofistikuar shkencor përmes tezave të tyre, dhe njëkohësisht, mundëson që shkathësitë e ndryshme të studentëve të vijjnë në shprehje në tezën e shkruar të magjistraturës.</p>	<p data-bbox="682 262 1529 304">Vlerësimi</p> <p data-bbox="682 336 1529 378">Vlerësimi i lëndës dhe disertacionit.</p>

Ç. Shkathtësitë themelore:

Komunikimi dhe shkrimi

Pas kryerjes së programit me sukses, studentët aftësohen:

- a) Ta shfrytëzojnë gojarisht/me shkrim gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, lidhur me çështjet rreth sferës së të drejtës penale;
- b) Të angazhohen në mënyrë efikase dhe konstruktive në dëshmitë dhe diskutimet për çështjet komplekse në gjuhën shqipe, maqedonase dhe në gjuhën angleze;
- c) të bëjnë prezantimin e qartë dhe koherent për ndonjë temë ose detyrë, duke përdorur materiale të ndryshme;
- ç) Të lexojnë materiale komplekse të cila janë ose nuk janë të lidhura me sferën e të drejtës penale.

Ligjëratat/mësimi

Punimet e seminarit, prezantimet në orë, diskutime. Përgatitjet, të shkruarit dhe reflektimi nga vlerësimi i lëndës së shkruar, duke e përfshirë edhe doktoratën.

Vlerësimi

Vlerësimi i lëndës së shkruar, vlerësimi i prezantimeve në orë, si dhe realizimi i punës së vlerësuar praktike. Provimi me gojë dhe me shkrim.

17. Struktura e programit studimor, kushtet e studimit, niveli, moduli, kreditë

Studime pasuniversitare do të zgjasin nga fusha e të drejtës penale do të zgjasin (2) vite akademike, përkatësisht tre semestra, të përbërë nga pesë lëndë dhe një semester teza e magjistraturës. Lëndët në semestra janë të obligueshme, ndërsa të tjerat janë zgjedhore. Çfo lëndë e dëgjuar, dhe me sukses është kaluar në provim, studentit do t'i sjell 6 (gjashtë) kredi, kurse teza e magjistraturës do t'i sjell 30 kredi. Kjo donë të thotë se për kryerjen me sukses të studimeve pasuniversitare janë të nevojshme 120 kredi. Secila lëndë duhet të kryhet duke i plotësuar edhe kërkesat e shtruara në silabusin (programin) e lëndës.

PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE PËR TË DREJTËN PENALE

<i>Semestri 1</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror / Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë angleze	6	D	22	22	180	
Metodologjia e së drejtës	6	D	22	22	180	
E drejta penale	6	D	22	22	180	
Kriminalistikë	6	D	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 2</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror / Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Penologji	6	V	22	22	180	
E drejta penale procedurale	6	V	22	22	180	
E drejta penale ndërkombëtare	6	V	22	22	180	
Kriminologji	6	V	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	V	22	22	180	
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 3</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror / Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Viktimologji	6	D	22	22	180	
Krimi i organizuar	6	D	22	22	180	
E drejta për kundërvajtje	6	D	22	22	180	
Mjekësia ligjore	6	D	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 4</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror / Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
-------------------	----------------	------------------------	---------------------	----------------------	--------------------------------	---------------------------

Shkrimi i tezës	30	V			900	
Gjithsej	30				900	

Lëndët zgjedhore:

1. Tregtia me njerëz dhe të drejtat e njeriut
2. Psikologjia gjyqësore
3. Kontrabanda me njerëz
4. E drejta penale dhe delikuenca e të miturve

PËRSHKRIMI I LËNDËVE OBLIGATIVE**SEMESTRI 1****Metodologjia e së drejtës**

Metodologjia e së drejtës i studion metodat e njohjes së të drejtës dhe dhe llojet e saj, si dhe metodat e krijimit, interpretimit dhe zbatimit të së drejtës, që janë të nevojshme për procesin hulumtues në të gjitha sferat juridike dhe në të gjitha nivelet e arsimimit akademik.

E drejta penale

Me nocionin e së drejtës penale përfshihet dega juridike e së drejtës pozitive të një shteti dhe disiplinë shkencore, përkatësisht shkencë e së drejtës penale.

E drejta penale ka për qëllim mbrojtjen nga kriminaliteti me sanksionimin e veprave ose sjelljes që janë paraparë si vepra penale, dhe për të cilat mund të shqiptohen sanksione penale, të paraparë me ligj për kryerësit e këtyre veprave.

Parimi ligjshmërisë së veprës penale dhe dënimit janë karakteristikat themelore të së drejtës penale. Ky parim është garanci për progres, humanizëm dhe demokraci, për arsye se paraqet shtyllë të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për eventualisht sjellje arbitrare të shtetit. Gjykatat mund t'i ftojnë qytetarët në përgjegjësi penale dhe mund të shqiptojnë sanksione të caktuara penale, vetëm nëse janë kryerës të ndonjë vepre, e cila paraprakisht me normat juridiko-penale është cilësuar si vepër penale.

Kriminalistikë

Kriminalistika paraqet një nga disiplinat që mësohet përgjithësisht në kuadër të së drejtës penale. Objekt i saj është studimi i mënyrave të ndryshme dhe të shumta të zbulimit të veprës së kryer penale, zbulimi dhe ndjekja e kryerësit të veprës dhe përmes kësaj, realizimin e së drejtës. Të mësuarit e kriminalistikës e përfshinë teknikën kriminalistike, taktikën dhe metodikën si tërësi të saj dhe mënyrat e strukturimit. Qëllimi i saj është

mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti përmes zbulimit të tij dhe ndjekjen e kryerësi të veprës.

SEMESTRI 2

Penologjia

Lënda e penologjisë i studion teoritë e ndëshkimit, të cilat kanë dominuar gjatë historisë, për t'u përqendruar në konceptet moderne të ndëshkimit dhe metodat e realizimit të tij. Me këtë rast analizon përshtatshmërinë e sistemit të dënimeve në suaza globale, e posaçërisht në Republikën e Maqedonisë, duke e vlerësuar suksesin e atyre sistemeve dhe rezultatet e tyre. Gjithashtu, lënda i analizon edhe institutet: rehabilitimin, edukimin dhe risocializimin e të dënuare për vepra penale.

E drejta penale procedurale

Lënda E drejta penale procedurale e studion këtë degë e cila paraqet përmbledhjen e normave juridike, të cilat i rregullojnë veprimet juridike të subjekteve në procedurën penale. Procedura penale i rregullon marrëdhëniet midis subjekteve në procedurën penale, duke i caktuar të drejtat dhe detyrat e tyre në të gjitha fazat e procedurës. Në procedurën penale harmonizohen: marrëdhëniet procedurale, formate procedurës dhe garancitë procedurale.

E drejta penale ndërkombëtare

Kjo lëndë e studion evolucionin e të drejtës penale ndërkombëtare nga Ninbergut dhe Tokio, e deri në zhvillimin e tribunalit ndërkombëtar për Ruandën dhe Jugosllavinë dhe themelimin e Gjyqit ekzistues penal ndërkombëtar në Hagë (Statuti i Romës 1998). Kjo lëndë i analizon gjykimet transnacionale, si atë të Pinoçes, dhe qëllimi i saj është të ofrojë informacione të hollësishme për disa doktrina fundamentale të përgjegjësisë penale ndërkombëtare dhe shfrytëzimin e modeleve procedurale për gjykimin e këtyre rasteve. Me këtë rast, vëmendje do t'u kushtohet edhe koncepcioneve të gjenocidit, veprave penale kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës.

Kriminologji

Kriminologjia i studion koncepcionet, të cilat e rrethojnë kriminalitetin, kryerësit e veprave penale dhe përgjigjen e shoqërisë. Studentët do të njihen me analizat e hollësishme të çështjeve teorike, metodologjike dhe politike lidhur me kriminologjinë dhe të drejtën kriminale. Kjo lëndë siguron njohuri fundamentale për shumë teori të kriminologjisë, të cilat e sqarojnë kriminalitetin. Kjo lëndë, gjithashtu, përqendrohet edhe në natyrën dhe dinamikën e kriminalitetit, kriminelëve, viktimat, shoqërinë, të drejtën dhe të ngjashme.

SEMESTRI 3

Viktimologji

Viktimologjia është një shkencë e re në kuadër të disiplinave penalo-juridike, e cila fiton rëndësi gjithnjë e më të madhe. Kjo është shkencë e cila e studion statusin e viktimës në të drejtën penale. Në kuadër të kësaj lënde analizohet raporti midis viktimës dhe kryerësit të veprës penale, si dhe raportet midis viktimës dhe organeve kompetente shtetërore për ndjekjen e kryerësve të veprave penale (policia, prokuroria publike, gjyqi etj.). Në kuadër të kësaj lënde studiohen edhe mënyrat e kompensimit të parapara për zhdëmtimin e viktimës.

Krimi i organizuar

Lënda krimi i organizuar përqendrohet në faktin se krimi i organizuar është problem konstant në rritje në Europë. Veprat, siç janë tregtia me njerëz, kontrabanda me drogë, larja e parave, vjedhjet ndërkombëtare, prostitucioni, tregtia e palejueshme me armë dhe të ngjashme, janë temat kryesore të këtij lëmi. Kjo lëmi do të studiojë efektin që kanë këto vepra në shtetin tonë dhe si është zhvillimi i tyre për inkuadrim në UE, dhe në kuptimin juridik do t'i analizojë edhe mënyrat e luftës kundër tyre, duke i përfshirë edhe sistemet e kontrollit të vendit dhe ndërkombëtar.

E drejta e kundërvajtjes

Kjo lëndë e studion të drejtën e kundërvajtjes dhe pozicionin e saj në raport me të drejtën penale në Republikën e Maqedonisë. Studentët do të kenë mundësi të njihen me dispozitat ligjore të këtij lëmi, të cilat vlejné në Republikën e Maqedonisë dhe do t'i analizojné rastet nga kjo sferë.

Mjekësia ligjore

Mjekësia ligjore i studion aspektet mjekësore të analizës së veprave penale përmes studimit të metodave të analizave dhe mënyrave, kohën dhe vendin e kryerjes së disa veprave penale. Kjo lëndë e definojnë e rëndësinë e mjekësisë ligjore për zbulimin, dëshmimin dhe akuzimin e kryerësve të veprave të caktuara penale.

PËRSHKRIMI I LËNDËVE ZGJEDHORE

Tregtia me njerëz dhe të drejtat e njeriut

Kjo lëndë i studion zhvillimin e problemeve botërore dhe aktualizimin e tyre në nivel ndërkombëtar dhe nacional. Pas një analize të shkurtër të zhvillimit historik për këtë çështje, kjo lëndë i studion instrumentet moderne ndërkombëtare në nivel ndërkombëtar dhe rajonal për rregullimin e këtij problemi, duke potencuar me këtë rast lidhshmërinë e saj me marrëdhëniet penalo-juridike në shoqëri, duke i analizuar në mënyrë përfundimtare

dispozitat ekzistuese juridike që i ofron legjislatura jonë ndërkombëtare në luftë kundër këtij lloji të kriminalitetit.

Psikologjia gjyqësore

Kjo lëndë në aspekt psikologjik i analizon veprimet dhe profilet psikologjike të kryerësve të veprave penale. Lënda mundëson qasje në teknikat profesionale të kësaj sfere

Kontrabanda me njerëz

Kjo lëndë i studion llojet e krimit në nivel ndërkombëtar përmes analizës së Protokollit të Kombeve të Bashkuara për kontrabandën me njerëz, duke e analizuar me këtë rast zbatimin e këtyre dispozitave në legjislaturën tonë penale.

E drejta penale dhe delikuenca e të miturve

Kjo lëndë e studion mënyrën në të cilën përcaktohet delikuenca e të miturve në legjislaturën tonë penale. Studentët i studiojnë proceset e identifikimit të delikuentëve, zhvillimin historik të kësaj sfere dhe politikat momentale për mposhtjen e këtij lloji të krimit dhe rehabilitimin e kryerësve të tij.